

DREJTORIA RAJONALE E OSSH GJIROKASTËR

Drejtuar: SENKA sh.p.k me NUIS J94808405Q, me adresë Fier, Lushnje “Xhevdet Nepravishta”.

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur-Punë

Numri i procedurës / referenca e Lotit: : REF-86015-11-01-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi i rrjetit kabllor 20 Kv, Fideri –F8,F9,F10 nënstationi Gjirokastër 110/35/20Kv (Zona Kardhiq)-Faza 1”, me fond limit: 79,526,869 (*shtatëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë*) lekë pa TVSH, me afat realizimi 4 (katër) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE AZM 2018 sh.p.k me NUIS L89431501M & EDICOM sh.p.k me NUIS J61813038H
Vlera: 64.272.495(*gjashhtëdhjetë e katër milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë*) lekë pa TVSH.

2. A.91 sh.p.k me NUIS J64505806V
Vlera: 79.036.083 (*shtatëdhjetë e nëntë milion e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë e tre*) lekë pa TVSH.

3. Aci Engineering sh.p.k me NUIS L51609014F
Vlera: 0 (*zero*) lekë pa TVSH.

4. BOE CAUSHI M sh.p.k me NUIS L88419801O & KMK sh.p.k me NUIS L78223801E
Vlera : 65.731.801 (*gjashhtëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e një*) lekë pa TVSH.

5. SENKA sh.p.k me NUIS J94808405Q
Vlera : 73.777.707,89 (*shtatëdhjetë e tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatë presje tetëdhjetë e nëntë*) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE AZM 2018 sh.p.k me NUIS L89431501M & EDICOM sh.p.k me NUIS J61813038H,
për arsyet e mëposhtme:

a) Referuar VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 88 pika 1, është përcaktuar qartësisht që Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. Në rastin konkret është cituar në kontratën e bashkëpunimit së AZM shpk pjesë e BOE merr përsipër të kryej respektivisht 35 % të zërave të punimeve sipas preventivave bashkëlidhur ofertës ekonomike dhe EDICOM shpk pjesë e BOE merr përsipër të kryej respektivisht 65 % të zërave të punimeve sipas preventivave bashkëlidhur ofertës ekonomike. Ndërkohë në ofertën ekonomike/preventivat të paraqitur analitikisht me zëra dhe vlerë vihet re që AZM shpk rezulton me 13.22 % të totalit ndërsa EDICOM shpk me 86.78 % të totalit. Pra, përse më sipër ky BOE skualifikohet.

b) Në rast bashkimi të operatoreve ekonomik, secili prej anëtareve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarreveshje.

(neni 88, pika 3 e VKM nr. 285, date 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”). OE AZM shpk nuk plotëson kriterin 2.3.2 të dst pasi për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme: N.P- 11- B Ndërtime për n/stacionet,kab transformacionit,linjat TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë ndërkohë ky operator vetëm kategorinë A disponon.(sipas preventivave që ky OE ka paraqitur).

c) Në rast bashkimi të operatorëve ekonomik, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

(neni 88, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”). EDICOM shpk nuk plotëson kriterin 2.3.8 të dst pasi operatori ekonomik ofertues referuar % bashkëpunimit duhet të ketë në stafin e tij të paktën 3 (tre) punonjës elektrikist, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë, me kontrate pune të vlefshme, dëshmi profesionale (diplome, certificate trajnimi etj.), të pajisur minimalisht me Grupin e IV të Sigurimit Teknik (te vlefshme). Në shtojcën nr. 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit, e cila përmbushet nga Operatorët Ekonomik nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST-ve EDICOM shpk 2 punonjës ka deklaruar .

d) Në rast bashkimi të operatoreve ekonomik, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, te LPP-se, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

(neni 88, pika 3 e VKM nr. 285, date 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”). EDICOM shpk nuk plotëson kriterin 2.3.9 të dst pasi operatori ekonomik ofertues referuar % bashkëpunimit duhet të ketë në stafin e tij të paktën 3 (tre) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë në rast se mjete e punës (makineritë) janë në pronësi të operatorit.

Në rastet kur makineritë disponohen me qira, nuk është e nevojshme që manovratorët e mjeteve të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Në këtë rast ata duhet të kenë të vlefshme vetëm kontratën e punës dhe dëshmitë e drejtimit. Në shtojcën nr. 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit, e cila përmbushet nga Operatorët Ekonomik nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 te DST-ve EDICOM shpk nuk ka deklaruar asnjë punonjës .

e) BOE nuk ka paraqitur grafikun e punimeve.

2. OE A.91 sh.p.k me NUIS J64505806V për arsyet e mëposhtme:

- a) Te kriteret e veçanta të kualifikimit , pika 2.3.5 ku citohet se : Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata te tjera dhe do te jete i pranishem gjate gjithe kohes qe do te kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin përkatës , nga ana e administratorit nuk është bërë kjo deklaratë.
- b) Te kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.8 ku citohet se : Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 5 (pesë) punonjës elektrikist, të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë, me kontrate pune të vlefshme, dëshmi profesionale (diplome, certificate trajnimi etj.), te pajisur minimalisht me Grupin e IV të Sigurimit Teknik (të vlefshme). Ky kriter përmbushet

nëpërmjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 të DST-ve. OE nuk e ka paraqitur këtë informacion në shtojcën përkatëse.

- c) Te kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.8 ku citohet se: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë te punësuar minimalisht 4 (katër) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë në rast se mjete e punës (makineritë) janë në pronësi të operatorit. Në rastet kur makineritë disponohen me qira, nuk është e nevojshme që manovratorët e mjeteve të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Në këtë rast ata duhet të kenë të vlefshme vetëm kontratën e punës dhe dëshmitë e drejtimit. Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve. OE nuk e ka paraqitur këtë informacion në shtojcën përkatëse.
- d) Te kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.11 ku citohet se : Për Listën e mëposhtme të artikujve: Kabëll XLPE gershet(trefoil) 20kV AL 3x1x240mm², Muftë TM. 20kV per kabell XLPE gershet AL 3x1x240mm² , trefoil ,Shirit sinjalizimi per kablo 20 kv ,Tuba PVC Ø = 160 mm (parete te trasha $\delta \geq 3.2$ mm) Operatori ekonomik duhet te paraqese: *Operatori ekonomik ne rastin kur nuk eshte prodhues duhet te vertetoje me marreveshje bashkepunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) te zyrtarizuar, e cila te tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: telefon, e-mail, eebsite, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi, si dhe duhet te paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike ose ekuivalenti i tij/saj) nga te cilat specifikimet teknike te produkteve te kerkuara te jene ne gjuhen e ofertes. Katalog/skede teknike te prodhuesit ku te paraqiten specifikimet teknike te ofertuara OE nuk i ka paraqitur autorizimet përkatëse.*

3. BOE CAUSHI M sh.p.k me NUIS L88419801O & KMK sh.p.k me NUIS L78223801E, për arsyet e mëposhtme:

- a) Sipas vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, Neni 88 pika 1 është përcaktuar qartësisht që Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomike, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njeri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjate procedurës dhe, në rast perzgjedhjeje, edhe gjate zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkepunimi të hartuar ndërmjet palëve. Në rastin konkret është cituar në kontratën e bashkepunimit se Caushi M shpk pjesë e BOE merr persiper të kryej respektivisht 18.17 % të zerave të punimeve sipas preventivave bashkelidhur ofertes ekonomike dhe KMK shpk pjesë e BOE merr persiper të kryej respektivisht 81.83 % të zerave të punimeve sipas preventivave bashkelidhur ofertes ekonomike. Nderkohe në oferten ekonomike/preventivat të paraqitur analitikisht me zera dhe vlere vihet re që Caushi M shpk rezulton me 18.17% të totalit ndërsa KMK sh.p.k me 81.83 % të totalit. Pra, përse më sipër ky BOE skualifikohet.
- b) Skualifikohet CAUSHI M shpk & KMK sh.p.k sepse nuk plotëson kriterin 2.3.1 të dst për përvojën e mëparshme, pasi me dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve vlere e tyre, e llogaritur për shërbime të ngjashme me objektin që prokurohet për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlere monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- c) Në rast bashkimi të operatorëve ekonomik, secili prej anëtareve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në

punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. (neni 88, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”). OE Caushi M sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.3.2 të dst pasi për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme: N.P. 1- B Punime gërmimi në tokë dhe N.P- 11- B Ndërtime per n/stacionet,kab transformacionit,linjat TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë, ndërkohë ky operator vetëm kategorinë A disponon.

d) Në rast bashkimi të operatorëve ekonomik, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. (neni 88, pika 3 e VKM nr. 285, date 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”). KMK sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.3.8 te dst pasi operatori ekonomik ofertues referuar % bashkëpunimit duhet të ketë në stafin e tij të paktën katër punonjës elektrikist, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë, me kontratë pune të vlefshme, dëshmi profesionale (diplomë, certificate trajnimi etj.), të pajisur minimalisht me Grupin e IV të Sigurimit Teknik (të vlefshme). Në shtojcën nr. 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit, e cila përmbushet nga Operatorët Ekonomik nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST-ve *KMK sh.p.k nuk i ka deklaruar këta punonjës*.

e) BOE nuk ka paraqitur grafikun e punimeve.

4. Aci Engineering sh.p.k me NUIS L51609014F

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës rezulton se ky OE nuk përmbush asnjë nga kriteret e vendosura në Dokumentat e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë SENKA sh.p.k me NUIS J94808405Q, me adresë Fier, Lushnjë “*Xhevdet Nepravishta*”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 73.777.707,89 (*shtatëdhjetë e tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatë presje tetëdhjetë e nëntë*) lekë pa TVSH/ totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.